



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi a) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Sharr Morina BI" të datës 26.12.2025 kundër njoftimit për dhënie të kontratës të datës 24.12.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Trajnimi dhe furnizimi për identifikimin e parasë së falsifikuar" me nr. të prokurimit 616-25-5312-1-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **HEDHET POSHTË si e pasafatshme** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Sharr Morina BI" të datës 26.12.2025 kundër njoftimit për dhënie të kontratës të datës 24.12.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Trajnimi dhe furnizimi për identifikimin e parasë së falsifikuar" me nr. të prokurimit 616-25-5312-1-2-1.
- II. **ANULOHE**t vendimi i AK për miratimin e pjesshëm të kërkesës për rishqyrtim i publikuar me datë 31.12.2025 në platformën E-Prokurimi.
- III. **VËRTETOHE**t njoftimi për dhënie të kontratës i datës 24.12.2025 si dhe njoftimin mbi vendimin e AK i datës 17.07.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi si dhe **LEJOHE**t autoriteti kontraktues që të vazhdoj tutje me këtë procedurë të prokurimit.
- IV. **NJOFTOHE**n të gjitha palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Sharr Morina BI" (tutje "parashtruesi") me datë 26.12.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për dhënie të kontratës të datës 24.12.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Trajnimi dhe furnizimi për identifikimin e parasë së falsifikuar" me nr. të prokurimit 616-25-5312-1-2-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur që njoftimi mbi vendimin e AK - B58 është publikuar me datë 17.07.2025.

Përmes nenit 60 par. 60.1 nënpar. a) të RRPP është përcaktuar se "Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit të AK (B58) është dita (0)". Në rastin konkret dita zero (0) është data 17.07.2025 kur është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK. Ndërsa dita e fundit kur ka mundur të parashtrihen kërkesat për rishqyrtim është data 22.07.2025 deri në ora 16:00. Mirëpo parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën e tij për rishqyrtim me datë 26.12.2025 respektivisht kërkesa është dorëzuar rreth pesë (5) muaj pas afatit ligjor. Në këtë mënyrë është gjetur se kërkesa për rishqyrtim është jashtë afatit dhe duhet të hedhet poshtë si e tillë.

Sa i përket vendimit të datës 31.12.2025 përmes të cilit gabimisht është miratuar pjesërisht kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit, me këtë rast ka ndodhur një gabim teknik pasi që me datë 24.12.2025 është publikuar njoftimi për dhënie të kontratës dhe jo njoftimi mbi vendimin e AK - B58. Prandaj përmes këtij vendimi anulohet vendimi i dt. 31.12.2025.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se kërkesa për rishqyrtim është paraqitur pas afatit të përcaktuar me nenin 60 paragrafin 60.1 paragrafin b) të RRPP dhe si e tillë ajo duhet të refuzohet si palejuar përkatësisht si e pasafatshme në kuptim të nenit 62.1. paragrafit a) lidhur me nenin 63 paragrafit 63.1 nënparagrafit 63.1.1 pikës b) të RRPP.

Për pikën I, II dhe III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.1 pikën b) lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1 nënparagrafin b) si dhe nenin 60 paragrafin 60.1. nënparagrafin a) të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 05.01.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.